



“Rritje eksponenciale e agroturizmit”, Civici: Deri në 2027, synojmë 100 certifikime. Rrapaj: T’i shfrytëzojmë mundësitë për zhvillimin e zonave rurale

Faqe 10



Sektori i shoqërive të kursim-kreditit u rrit me 6.3% vitin e kaluar

Faqe 2



Sipërmarrësi i agroturizmit “Alpet” në podkasting “Flasin”: Investimet kanë ndryshuar Thethin

Faqe 2



AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KESHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit shkurt 2024

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 480
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

SFIDAT E BUJQËSISË DHE TË FERMERËVE, FLASIN EKSPERTËT

PROTESTAT E FERMERËVE, PASOJË E PROBLEMEVE TË PAZGJIDHURA NË BUJQËSI

Për emisionin “Money” nga Neriton Gjergo, flet Agim Rrapaj (Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar), Alban Zusi (Kryetar i Shoqatës së Eksporteve), Eduart Sharka (Drejtues i politikave Agrare, PD), të cilët evidentojnë problemet me të cilat po përballet bujqësia shqiptare dhe disa nga hapat që duhet të ndiqen për të përmirësuar të ardhmen e sektorit

GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Mbrojtja biologjike, potencial për vlerë të shtuar në eksportet bujqësore

Faqe 5

KËNDI I MBROJTJES INTELEJENTE TË BIMËVE

Bujqësia dhe agroturizmi

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike



(Artikulli i sotëm trajton dy probleme: Agroturizmi dhe bujqësia dhe informacionet e fundit për zhvillimet në bujqësinë biologjike botërore, evropiane dhe në Ballkanin Perëndimor)

Faqe 11



GRATË NË SIPËRMARRJE

“Women On Boards Albania” zhvillon konferencën e parë të saj. Fuqizimi i gruas në rolet drejtuese domosdoshmëri e zhvillimit ekonomik dhe integritimit të Shqipërisë në BE

Faqe 6

TEMA TË DITËS

- Nisin përgatitjet për mbjelljen e bimëve - Specialistët rekomandojnë spërkatjen e pemëve Fq.4
- Tregu i vajit favorizon kulturën e ullirit, në njësinë Kurjan janë mbjellë 6000 rrënjë të reja Fq.5
- Sa e vështirë të rrisësh presh? Fermerët në Qerretin e vjetër të Lushnjes tregojnë lodhjen si kultivues: Do shumë krahë pune... Fq.6
- Bashkohen fermerët e serrave, vendosin çmime dyshe me prodhimet e reja Fq.7
- Kalendari bujqësor, muaji mars 2024 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

FINANCIM

300 milionë lekë për startup-et, Ymeri: Fokus turizmi, agroturizmi, energjia, prodhimi



Faqe 4

Sektori i shoqërive të kursim-kreditit u rrit me 6.3% vitin e kaluar

FED Invest konsiderohet si një nga lëvizjet më të mëdha për progres në zonat rurale dhe periurbane në këto 30 vitet e fundit në vendin tonë, ku të gjithë së bashku ndërtojnë një biznes inovator, në pronësi të anëtarësisë. Duke ndihmuar çdo individ e çdo familje, e duke dhënë kontribut në zhvillimin e vendit dhe të ardhmen e fëmijëve tanë

Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, totali i aktiveve të tregut në fund të vitit 2023 arriti vlerën e 15.6 miliardë lekëve ose pothuajse 150 milionë eurove.

Shoqëritë e kursim-kreditit ose kooperativat financiare janë institucione të lejuara me ligj të pranojnë depozita nga anëtarët dhe të ofrojnë kredi për ta. Modeli i SHKK-ve ka rezultuar veçanërisht efikas për financimin e atyre segmenteve të shoqërisë që, për arsye të ndryshme, kanë akses të kufizuar në sektorin bankar. Ato janë një segment i mikrofinancës veçanërisht i suksesshëm në zonat rurale të vendit, me fokus kryesor financimin e ekonomive bujqësore.

Portofoli i kredisë të dhënë nga SHKK-të në fund të vitit 2023 arriti në pothuajse 12 miliardë lekë, me rritje prej 11.9% krahasuar me një vit më parë.

Pjesa tjetër e aktiveve konsiston kryesisht në depozita të vendosura në institucione të tjera financiare, ndërsa një pjesë të papërfillshme zënë investimet në letrat me vlerë dhe aktivet jo financiare.

Aktiviteti ndërmjetësues i SHKK-ve mbështetur, në pjesën më të madhe, të depozitave të anëtarëve. Në fund të vitit 2023, depozitat përbënin më shumë se 70% të detyrimeve totale të sek-



torit. Në vlerë ato prekën shifrën e 11 miliardë lekëve, në rritje 5.7% me bazë vjetore.

Edhe në sektorin e SHKK-ve në dy vitet e fundit po vërehet një rritje e peshës së depozitave në valutë të huaj. Vitin e kaluar depozitat në valutë i rritën me 14.7%, pavarësisht efektit negativ të kursit të këmbimit (bilanci raportohet në lekë). Ndërsa depozitat në monedhën vendase shënuan një rritje të ulët, me 3.5% krahasuar me vitin 2022.

Pesha e depozitave në valutë ndaj totalit ka arritur në 21.1%, nga 19.5% që kishte qenë një vit më parë.

Rritja e depozitave të SHKK-ve vitet e fundit është mbështetur shumë edhe nga përfshirja e tyre në skemën e sigurimit të depozitave. Që prej vitit 2017, depozitat pranë SHKK-ve janë të siguruar deri në vlerën e dy milionë lekëve.

Por, sigurimi bëhet efektiv vetëm në momentin kur SHKK-ja përkatëse anëtarësohet në skemën e sigurimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Për këtë qëllim, SHKK-të duhet të certifikohen dhe të marrin një vërtetim të përmbljes së kriterëve nga Këshilli Drejtues i ASD-së. Megjithatë, disa prej SHKK-ve ende nuk janë anëtarësuar në skemën e sigurimit të depozitave, sipas kërkesave ligjore.

Sipas Bankës së Shqipërisë, aktualisht në Shqipëri ekzistojnë 16 SHKK të licencuara, por pesë prej tyre e kanë pezulluar aktivitetin në periudhën 2015-2016. Mbështetur në informacionin zyrtar ngelen 11 SHKK aktive, por Agjencia e Sigurimit të Depozitave raporton vetëm nëntë subjekte të anëtarësuar në skemën e sigurimit të depozitave.

Rreth 50% e portofolit të kredisë në SHKK FED invest është disbursuar në zonën rurale dhe më së shumti, në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë. Volumi i financimit dhe vlera mesatare e financimit në sektorin e bujqësisë ka ardhur në rritje si rrjedhojë e natyrshme e konsolidimit dhe rritjes së madhësisë së fermave. Një lehtësim i fundit që ofron FED invest është ulja e ndjeshme e kërkesave të kolateralit edhe për financimin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME).

Një aspekt tjetër që FED invest i kushton rëndësi primare është transparencja me klientët dhe prezenca fizike në komunitetet e anëtarëve. Gjithashtu, edukimi financiar i anëtarëve të FED invest dhe më gjerë, është pjesë e vazhdueshme e fushatave dhe projekteve të ndërmarrja në bashkëpunim me partnerët tanë strategjikë.

Mbështetje financim nga FED Invest/ Luan Përfundi nga emigrant në sipërmarrës në blegtori

Analiza e mundësive dhe mënyrat e rritjes së biznesit me të njëjtat kosto

Me një përvojë 18 vjeçare të fituar në një fermë blegtoriale në Itali, Luan Përfundi rikthehet me një vizion të qartë për të ndërtoar një model suksesi në Fermë - Sukth, Shqipëri!

Falë financimit të FED invest-it, ai arriti të ndërtojë një stallë që numëron sot 35 krerë lopë.

ABA Online sëbashku me

eksperten e saj, znj. Valbona Ylli, vizituan fermën e z. Luan për të parë më në detaje menaxhimin e saj dhe ofrimin e asistencës teknike, për të rritur prodhimin e qumështit dhe për të kryer një analizë të thellë të fermës së tij.

Demonstrimin praktik të plotë mund ta ndiqni në ABA Online duke klikuar në linkun: <https://www.abaonline.al/>

Article/SingleArticle...
Vijo me të dhënat për më shumë shërbime ABA! <https://bit.ly/32SYFFi>

Qendra ABA për tu përgjigjur nevojave të fermerëve shqiptarë për përmirësimin e biznesit të tyre ka përzgjedhur një Ekip Ekspertësh, të cilët përgatisin informacion objektiv, bashkëkohor dhe të besueshëm.

Sipërmarrësi i agroturizmit “Alpet” në podkastin “Flasim”: Investimet kanë ndryshuar Thethin

I ftuari i radhës i kryeministrit Edi Rama në podkastin “Flasim”, ishte njëri nga Thethi, i cili nuk është larguar kurrë nga vendlindja por ka ndërtoar të ardhmen e vetë aty, duke ngritur një biznes familjar.

“Në episodin 5, sezoni 3 i podkastit ‘Flasim’, ‘Gur i rëndë në vend të vet’, do të njiheni me një djalë malesh që kurrë nuk ra teposhtë në qytet e nuk mori rrugët e botës, po krejt botën e solli në malin e tij”, u shpreh Rama në fillim të prezantimit.

Ndërsa u ndal te sfidat me të cilat është përballur për ngritjen e këtij biznesi familjar, administratori i bujtinës “Alpet” Fatmir Berisha vlerësoi veçanërisht investimet e kryera nga qeveria gjatë viteve të fundit në Theth.

“Rruga është asfaltuar dhe ka 3 vite që gjatë dimrit ka borëpastruese dhe nuk kemi probleme. Të gjitha një nga një po rregullohen falë qeverisë”,

u shpreh Berisha.

Nga ana e tij, Kryeministri iu përgjigji të gjithë atyre që ankohen për mungesën e vëmendjes së qeverisë ndaj veriut të vendit, duke nënvizuar se për veriun këto vite është bërë më tepër se në të gjitha vitet e marra së bashku.

“Thonë po veriu, keni harruar veriun... Por jo vetëm nuk është kështu, por sa është bërë për veriun në këto vite, nuk është bërë në të gjitha këto vite të marra së bashku dhe ne do të vazhdojmë”, siguroi Rama.

Kryeministri nënvizoi se në Theth ka disa çështje të mbetura me disa legalizime, por më në fund u arrit të bllokoheshin ndërtimet që bëheshin kot më kot.

“Nuk janë bërë shumë për fat të mirë, por prapë janë bërë disa që nuk duheshin bërë. Duhet ndërtoar brenda planit, karakteristikave dhe atyre tipareve që ka zona dhe që kërkon industria e mikpritjes”,

u shpreh Rama.

Nga ana e tij, Berisha theksoi se në 2 vitet e fundit në Theth po punohet mjaftueshëm, aq sa nuk ka kapacitete hoteliere aq sa ka kërkesa dhe shumë njerëz po kthehen mbrapa se nuk kanë mundësi t'i presin.

“Ka shumë emigrantë që mund të kthehen t'i restaurojnë shtëpitë e vjetra”, u shpreh ai.

Në këtë drejtim, kryeministri sqaroi se është ngritur një taskforcë për regjistrimin e pronave pasi në ndryshim nga zonat e tjera të Shqipërisë tokat në veri nuk janë ndarë me ligjin 7501.

“Aty për fat të mirë nuk ka konflikte. Ne kemi bërë ligjin dhe kemi ngritur taskforcën sepse duhen marrë dëshmitë e atyre rreth e rrotull që ta thonë me shkrim që nuk ka probleme që të procedohet me regjistrimet, por besoj se do bëhet”, u shpreh Rama.



Ibrahimaj: Gratë profesioniste, të angazhuara në rritjen e barazisë gjinore

Ministrja e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Delina Ibrahimaj deklaroi se gratë profesioniste janë të angazhuara në rritjen e barazisë gjinore dhe në forcimin e rolit të gruas në Shqipëri.

Ibrahimaj mori pjesë në takim motivues të organizuar nga Women on Board Albania, së bashku me gra profesioniste të fushave të ndryshme.

“Të gjitha janë të angazhuara në rritjen e barazisë gjinore dhe në forcimin e rolit të gruas në shoqëri, me fokus zhvillimin e sipërmarrjeve të qëndrueshme dhe novatore”, u shpreh ajo.

Në një botë që ndryshon me shpejtësi, gratë shqiptare po demonstrojnë guxim të jashtëzakonshëm për të ndjekur aspiratat e tyre dhe për të treguar

potencialin e tyre të vërtetë. Sipas ministres Ibrahimaj, roli i grave për zhvillimin e

isë dhe të rrisë me tej nismat e tyre në biznes. Të dhënat e INSTAT-it tregojnë se rreth 32 % e ndërmar-



znesit dhe më gjerë ekonomisë, është i pazëvendësueshëm, ndaj qeveria është e angazhuar të nx-

gojnë se rreth 32 % e ndërmar- rjeve në vend drejtohen nga gratë

INTERVISTA

SFIDAT E BUJQËSISË DHE TË FERMERËVE, FLASIN EKSPERTËT

PROTESTAT E FERMERËVE, PASOJË E PROBLEMEVE TË PAZGJIDHURA NË BUJQËSI

Për emisionin "Money" nga Neriton Gjergo, flet Agim Rrapaj (Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar), Alban Zusi (Kryetar i Shoqatës së Eksporteve), Eduart Sharka (Drejtues i politikave Agrare, PD), të cilët evidentojnë problemet me të cilat po përballet bujqësia shqiptare dhe disa nga hapat që duhet të ndiqen për të përmirësuar të ardhmen e sektorit

Problemet në bujqësi nuk kanë të sosur. Fermerët e Korrçës ankohen se mollët nuk mund t'i shesin, pasi çmimi i tyre del më i lartë sesa çmimi i mollëve që vijnë nga Serbia, Greqia dhe Maqedonia e Veriut. Në Gjirokastrë, blegtorët po humbin para pasi qumështi që ata po nxjerrin në treg po blihet nga përpunuesit me çmim nën kosto. Këto janë arsyt sepse këta njerëz janë revoltuar dhe kërkojnë zgjidhje për hallin e tyre. Protestat e fermerëve në Shqipëri gjatë viteve të fundit kanë qënë të shpeshta. Pamjet e qumështit që hidhet në rrugë, qepët dhe patatet në kanal, apo pemët që prihen me sëpatë janë të trishita. Përballja e fermerëve me humbje, si edhe kërkimi për mundësi të tjera, duket se po prish zinxhirin e funksionimit të një sektori, i cili jep 19% të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe mban në punë 45% të familjeve shqiptare.

Alban Zusi
(Kryetar i Shoqatës së Eksportuesve)

"Ndryshimi i gabuar që iu bë TVSH-së së produkteve bujqësore do të jepte këtë impakt, ndoshta jo në mënyrë të menjëhershme, pasi bujqësia kishte filluar një ngritje, por shumë subjekte e përjetuan në mënyrë dramatike dhe me kalimin e kohës pasojat do të ndiheshin.



Alban Zusi (Kryetar i Shoqatës së Eksportuesve)

Nëse elementi i parë ishte politikë monetar, tashmë kemi të bëjmë me një politikë fiskale, e cila rrit koston e prodhimeve vendase me 20%."

Një blegtor vendas e shiste

Agim Rrapaj
(Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar)

"Arsyeja kryesore është buxheti i pamjaftueshëm që i vendoset sektorit të bujqësisë,



Agim Rrapaj (Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar)

blegtorisë, peshkimit, agropërpunimit, agrobiznesit, agroturizmit dhe ky buxhet sjell ato pasoja që detyron fermerët të dalin në protestë."

Fondi i përgjithshëm për bujqësinë i qeverisë për vitin 2024 arrin në 137 milion euro dhe mbështet programe që synojnë rritjen e pagave, zgjerimin e eksporteve, blegtorinë dhe peshkimin, fuqizimin e sigurisë ushqimore dhe disa hallka të tjera. Ndër vite buxheti për ekonominë agrare është rritur dhe në vlerë nominale brenda një dekadëshume është dyfishuar, por politikat për ndarjen e këtyre parave nuk kanë dhënë rezultat, të paktën në disa drejtime.

Eduart Sharka
(Drejtues i Politikave Agrare, PD)

"Ne jemi anëtarë të marrëveshjes së CEFTA-s, e

cila është një marrëveshje midis gjashtë vendeve të rajonit dhe është bërë nën mbikqyrjen e Bashkimit Evropian. Në këtë marrëveshje thuhet se nëse do të kemi eksport të produkteve bujqësore nga njëri vend i rajonit në tjetrin, vendi ku eksportohen këto produkte, nëse janë të subvencionuara, duhet të vendosen tarifa mbrojtëse për produktin vendas."

parë ishte 50 lekë – 70 lekë, 70 lekë ishin 50 cent, ndërsa sot janë 70 cent. Kjo e motivon fermerin serb apo maqedonas që ta hedhë produktin në tregun shqiptarsepse merr shumë më tepër, ka hapësirë për të marrë marzhin e fitimit."

Eduart Sharka
(Drejtues i Politikave Agrare, PD)

"Molla e Serbisë ose Maqedonisë, apo të gjitha produktet që vijnë nga vendet e rajonit,



Eduart Sharka (Drejtues i Politikave Agrare, PD)

në rast se janë subvencionuar në vendin përkatës, në vendin tonë duhet të kenë tarifa në doganë, për të mbrojtur produktin vendas."

Krizat e përsëritura, humbjet, politikat fiskale, mungesa e infrastrukturës, dhe të tjerë faktorë që dekurajojnë investimet në ferma, kanë bërë që shumë fermerë të gjejnë mundësi të reja. Zhvendosja e tyre nga zonat rurale në qytet apo jashtë vendit ka tkurrur numrin e bagëtive apo të tokave që punojnë për vite të tëra.

Agim Rrapaj
(Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar)

"Importuesit janë më të fuqishëm se prodhuesit, ata mbizotërojnë financiarisht dhe potencialisht, pasi prodhuesit tanë janë të paorganizuar, të ndarë, të copëzuar, dhe pa një mbështetje."

Eduart Sharka
(Drejtues i Politikave Agrare, PD)

"Pas dy viteshstanjacion, tremujori i tretë dhe i katërt i vitit 2023, regjistroi -0.4% rënie të produktit bujqësor. Duhet të ndryshohen këto politika që implementohen sot, pasi kemi politika të gabuara fiskale. Kur e gjithë Evropauli barrën fiskale për fermerët, qeveria jonë shtoi 10% TVSH-

nëmbi inputet bujqësore, hoqi 6% kompesimin direkt për fermerët që kalonte 100 milion euro në vitin 2022."

Numri i gjedhëve në vendin tonë, po bie me 10%-15%, për pasojë edhe qumështi dhe mishi vendas po humbet në sasi. Censusi që do zhvillohet këtë vit do të japë një pamje më të qartë të tufave në vend, por të dhënat që jepen nga statistikat vjetore të bujqësisë tregojnë se deri në vitin 2022 popullatat e bagëtive po humbasin në raport të drejtë

mira klimatike.

Alban Zusi
(Kryetar i Shoqatës së Eksportuesve)

"Në vitet 2015-2018, kur sistemi fiskal u rregullua dhe sistemi monetar ishte në rregull, fermerët jo vetëm nxirrnin rrogat e tyre, por edhe nisën të investojnë dhe shumica e investimeve janë bërë nga fermerët vetë dhe jo nga subvencionet shtetërore. Shtesa kryesore ishte tregu i rregulluar, mekanizmat fiskalë dhe monetar që ndikojnë, rrisnin eksportin, ndaj fermeri shqiptar nisi të mendojë për të investuar."

Agim Rrapaj
(Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar)

"Konjunktura e tregut është e vendosur nga kërkesa dhe oferta, por nëse ne do të vendosim shpenzimet e duhura, të rrisim nivelin e shpenzimeve në sektor, të kryejmë investimet e duhura psh. në pentari, për të futur një metodë të re për sigurimin e tyre, atëherë mund të ndryshojë situata."

Kërkesat e fermerëve tanë për të dalë nga kriza, edhe për të investuar në toka të reja janë të lidhura me paratë. Nëse fondet dhe subvencionet për ta rriten, atëherë mundësitë për të shitur mallin dhe rritur prodhimin për ta shtohen.

Eduart Sharka
(Drejtues i Politikave Agrare, PD)

"Aktualisht sot një konsumator evropian paguan 33 cent në ditë subvencione për fermerin evropian, në formën e taksave, ndërsa tek ne kjo shifër është 15 herë më e vogël, 0.023 cent në ditë paguan në konsumator shqiptar për fermerët."

Protesta e tyre është e lidhur jo vetëm me grumbulluesit dhe përpunuesit, por edhe me qeverinë e cila duhet të dalë garant për t'i mbrojtur ata dhe formalizuar tregun.

Agim Rrapaj
(Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar)

"Roli kordinues i MBZHR-së nuk mund të mohohet, nuk mund të vetërregullohet tregu për faktorët objektiv, nuk mund të vetërregullohet tregu për të përbaluar pasojat e luftës në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme,

(Vijon në faqen 12)

FMN tregon si të rritet përfshirja e grave në punësim - "Fuqizoni aksesin në shërbimet e kujdesit për fëmijët dhe programet pas shkollës"

Mbështetja më e traqetur dhe politikat e ndërgjegjshme gjinore mund të përmirësojnë tregun e punës duke rritur pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në të gjithë nivelet e arsimit dhe reduktimin e dallimeve gjeografike.

Llogaritjet e stafit të FMN-së tregojnë se Shqipëria shpenzoi vetëm 0.7 për qind të buxhetit të vitit 2022 për politika aktive të tregut të punës. Në një analizë të publikuar së fundmi Fondi Monetar Ndërkombëtar thekson se shifra të ngjashme janë përfshirë në projektbuxhetin 2024, ku shpenzimet bruto për tregun e punës dhe Politikën e Arsimit dhe Formimit Profesional janë në nivelin 0.09 për qind e buxhetit të vitit 2024.

Përveç kësaj, politikat që adresojnë pjesëmarrjen e femrave në forcën punëtore, kanë pasur sukses të kufizuar, me

vetëm 1 për qind të grave që marrin pjesë në aktivitete aktive të programeve të tregut të punës.



FMN TREGON SI TË RRIKET PËRFSHIRJA E GRAVE NË PUNËSIM
"FUQIZONI AKSESIN NË SHËRBIMET E KUJDESIT PËR FËMIJËT DHE PROGRAMET PAS SHKOLLËS"

Sipas FMN, fuqizimi arsimor, si një mekanizëm më vete, nuk mund të sigurojë rritjen e nevojshme të pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore ose zvogëlimin e hendekut gjinor të pagave.

Prandaj Shqipëria duhet të forcojë sistemin e mbështetjes për fëmijët dhe të moshuarit



nëpërmjet zgjerimit të shërbimeve institucionale, pasi nevojat për kujdesje në Shqipëri plotësohen kryesisht nga gratë. Kjo përfshin rritjen e aksesit në shërbimet e kujdesit për fëmijët dhe programet pas shkollës.

Nisin përgatitjet për mbjelljen e bimëve - Specialistët rekomandojnë spërkatjen e pemëve

Ndodhemi në periudhën ku fermerët bëhen gati për mbjelljet e reja, por nga ana tjetër, kushtet e motit favorizojnë shfaqjen e sëmundjeve apo të

mos, për sa i përket procesit të spërkatjes në vreshtari, arrote dhe agrume.

Tashme ndodhemi në përdihen ku fermerët nisin përgatitjet



dëmtuesve të ndryshëm. Për të siguruar një ecuri sa më të mirë të proceseve biologjike të bimëve fermerët, duhet të konsultohen me specialistët, sidomos, për sa i përket procesit të spërkatjes në vreshtari, arrote dhe agrume.

për mbjelljen e kulturave perimore dhe kujdesin për fruta kulturat e ndryshme si vreshtari, agrume arrotet etj... specialistët e bujqësisë pohojnë se kujdesi

këtë vit nga ana e fermerëve duhet të jete shume i lartë për të shmangur dëmtimet që patën vitin e kaluar, dhe të ndjekin me përpikëri këshillat e specialistëve për të mos pasur dëmtime dhe rendiment të ulët në prodhim.

Agronomi Fejzo Xhanari thotë se nisur nga viti i kaluar ku sektori i bujqësisë pati dëmtime madhore të prodhimit për të shmangur të njëjtin situatë këtë vit duhet që fermerët të nisin që tani kujdesin për të mbjellat dhe kulturat frutore.

Sipas tij, fermerët duhet të kryejnë spërkatjet në intervalet e caktuara kohore për shmangien e sëmundjeve që kanë filluar të shfaqen në vreshtari, arrote dhe agrume.

Nga të dhënat në sektorin e bujqësisë vitet e fundit në Gjirrokastër janë shtuar sipërfaqet e mbjella me frutikultura të ndryshme si arrot, ullishte dhe agrume.

Këshillimi Smart - Mekanizimi sjell suksesin në bujqësi

Në Shqipëri në dispozicion të bujqësisë operojnë vetëm 10,241 traktorë me rrota, 5,984 mini-traktorë, 4,417 makina mbjellëse dhe 698 autokombanjanja, pra një nivel mekanizimi shumë i ulët. Konkretisht vetëm një traktor për 67 ha tokë bujqësore (pa përfshirë kodrinat) dhe një autokombajnë për 416 ha kultura arrash (drithëra). Ndërkohë që sipërfaqja me bimë arrash, perime, serra dhe bostanorë është 469,336 ha, dhe numri i pemëve frutore, ullishte, vreshta, agrume është 38 milion rrënjë.

Traktorët janë të prodhuar më shumë se 20 vite më parë, me një teknologji të vjetër, shumica janë traktorë dhe mjete të importuara të përdorura (jo marka perëndimore). Nga numri i traktorëve në punë vetëm rreth 2000 traktorë plotësojnë kriteret e BE-së për t'u shfrytëzuar me efikasitet në punimet bujqësore. Rreth 54 % e familjeve fermerë përdorin mjetet e mekanizuara për punimin e tokës, për kultivimin dhe vjeljen e bimëve. Shqipëria

përdor me efikasitet mesatarisht 1.24 traktorë për 100 ha tokë të punuar. Ndërsa Maqedonia e Veriut 6 traktorë, Greqia 6.6 traktorë, Italia 13.2 traktorë, Shtetet e Bashkuara Evropian 8.1 traktorë për 100 ha tokë.

RËNDËSIA E INVESTIMIT NË MEKANIKË BUJQËSORE

Mekanizimi ka revolucionarizuar operacionet në fermë dhe i ka mundësuar fermerëve të kryejnë detyrat në mënyrë më efektive dhe efektive. Për-

Arsimi profesional, Manjani: Ndryshimet ligjore synojnë rritjen e cilësisë

Në drejtimin e kryetares, Flutura Açka, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zhvilloi mbledhjen e radhës në platformën online "Zoom". Komisioni shqyrtoi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", propozim i deputetes Evis Kushi.

Propozuesja e kësaj nisme ligjore, Evis Kushi, gjatë fjalës së saj u shpreh se arsimi profesional duhet të jetë gjithmonë në fokus me qëllim rritjen e cilësisë dhe përshtatjen me nevojat që ka tregu i punës. "Gjithashtu duhet të ndërgjegjësohen të rinjtë dhe familjet e tyre për të rritur interesin në drejtim të arsimit profesional. Zhvillimi i turizmit dhe teknologjisë kanë bërë që të ketë kërkesa të shtuara në tregun e punës", u shpreh Kushi.

Ndërsa zëvendësministria

e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Olta Manjani, u shpreh se qëllimi i projektligjit lidhet me nevojën për përditësimin e kurrikulave,



njohurive dhe shërbimet që ofrohen nga institucionet publike të arsimit profesional. "Synohet rritja e cilësisë dhe standardeve të kualifikimeve profesionale duke garantuar të rinjtë dhe

të rejtat që kanë kompetenca bashkëkohore duke mundësuar një punësim të menjëhershëm dhe mirëpaguar. Jemi në mbështetje të këtij propozimi"

nënvizoi Manjani.

Më tej mbledhja e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik vijoi me pyetje dhe diskutime në lidhje me projektligjin e propozuar.

300 milionë lekë për startup-et, Ymeri: Fokus turizmi, agroturizmi, energjia, prodhimi

Për të ndihmuar sipërmarrjet e reja inovatore në Shqipëri, por edhe zhvillimin apo rritjen e mëtejshme të atyre ekzis-


Drejtori i Agjencisë "StartUp Albania" Arian Ymeri në një intervistë në medie, bëri të ditur se ky është fondi më i lartë i alokuar

milionë lekë", tha Ymeri.

Fokusi është tek sipërmarrësit në përgjithësi. Çdo lloj moshe apo industrie ka të drejtë të aplikojë.

"Ne duam të kemi një larmi aplikimesh nga çdo fushë. Pritshmëritë tona janë që do të financohen rreth 55-75 kompani dhe individë. Sektorët kryesorë janë turizmi, agroturizmi, energjia, prodhimi, BPO, ICT. Por edhe ide që vijnë nga fusha të tjera kanë po kaq shanse për tu përzgjedhur fitues. Një risi këtë vit është që nëse përberja e kompanisë është më shumë se 51% janë femra, ajo kompani apo grup individësh do të kenë bonus 5%", shprehet Ymeri.

Thirrja është në faqen e ministrit "sipërmarrja.gov.al", ku janë dhe dokumentet për tu plotësuar. Aplikimi bëhet tek E-Albania. Pagesat e punonjësve do të njihen deri në 25% të vlerës së grantit. Do të njihen dhe pagesat për ekspertët e mundshëm. Faza e dytë dhe e tretë financohen deri në 90 dhe 85 % të vlerës.



tuese, Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit dhe Agjencia e Startup Albania, hapën thirrjen për bizneset që duan të përfitojnë nga grantet prej 300 milionë lekësh të vëna në dispozicion për vitin 2024 nga Qeveria Shqiptare.

Duke nisur nga 16 shkurti, kushdo që ka një ide inovative për zhvillimin e një startup-i, mund t'i bashkohet garës për mbështetje financiare, e cila do të zhvillohet në tre faza.

ndonjëherë deri më sot.

"Janë tre faza financimi. Faza e parë është e ajo se kush ka një ide që kërkon ta zhvillojë përfiton 1.5 milionë lekë. Faza e dytë është ai biznes që është i regjistruar, por ende s'ka dalë në treg ose është pranë daljes, i cili do të përfitojë deri në 4.5 milionë lekë. Faza e tretë është një sipërmarrës që ka dalë në treg, por dot të zhvillohet më tej, prapë tregu vendas dhe përfiton deri në 9

rendimente dhe ulje të kostove të prodhimit.



Mekanizimi ka shumë përfitime në bujqësi dhe disa prej tyre po i listojmë si më poshtë:

- Rritja e Efikasitetit. Mekanizimi u mundëson fermerëve të punojnë në mënyrë më efektive dhe më të shpejtë se sa mund të përdorin metodat tradicionale.
- Përmirësim të cilësisë së punës. Mekanizimi ka përmirësuar edhe cilësinë e punës në

bujqësi.

- Reduktim të kostos së punës. Mekanizimi minimizon nevojën për punë manuale, e cila mund të jetë e shtrenjtë dhe kërkon kohë.

- Ruajtje më e mirë e burimeve. Mekanizimi ka çuar gjithashtu në ruajtje më të mirë të burimeve natyrore si uji dhe toka.

- Rritja e aksesit në tregje. Së fundi, mekanizimi u mundëson fermerëve të arrijnë tregje më të gjëra duke rritur kapacitetin e tyre prodhues dhe duke përmirësuar cilësinë e prodhimit të tyre.

GRATË NË SIPËRMARRJE

“Women On Boards Albania” zhvillon konferencën e parë të saj. Fuqizimi i gruas në rolet drejtuese domosdoshmëri e zhvillimit ekonomik dhe integritit të Shqipërisë në BE

Nisur nga temat e diskutuara dhe njohuritë e ndara gjatë konferencës mesazhet kyçe

ale kërkon të jesh lider i vetes • **Strategjitë dixhitale** do të përdoren për të kthyer modelet

“në “Women on Boards Albania”, ne mbrojmë një qasje holistike për avancimin e di-

një prani dhe kontribut të pamjaftueshëm ndikues të gruas shqiptare në nivelet më të larta



ishin:

- **Diversiteti i kapërcen kuotat:** Ka të bëjë me nxitjen e mendësive gjithëpërfshirëse dhe përparimin e qëllimshëm për të pasur më shumë gra në pozicione me ndikim.
- Diversiteti gjinor kërkon që **gratë të mbështesin njëra-tjetrën** dhe të ndërtojnë një sistem rrjeti strategjik
- Zhvillimi i qëndrueshëm i kompetencave të drejtimit arrihet më së miri kur është pjesë e **strategjive të rritjes**.
- Balancimi i rritjes profesionale dhe përmbushjes person-

përrjashtuese të vërejtura në vendimmarrjen strategjike.

- Fuqizimi i grave për të ndikuar në strategjinë e produktit dhe tregut, nëpërmjet **platformave dixhitale mund të përdoret për të sfiduar stereotipet**, por edhe për t'i pozicionuar gratë si prirje me ndikim në korporatë.
- **Dixhitalizimi ofron mundësi** të paprecedentë për të përforcuar **iniciativat arsimore**, duke lidhur gratë aspirante me burime, programe mentorimi dhe një rrjet global.

Albana Vrioni thekson se,

versitetit gjinor në drejtimin e korporatës. Nëpërmjet edukimit, lidhjes dhe implikimit, ne ushqejmë mendësitë e nevojshme për përparim. Gjatë pesë viteve të ardhshme, angazhimi ynë është të ndihmojmë në përgatitjen e 100 grave të nivelit drejtues dhe ekosistemet e tyre për sukses në rolet drejtuese dhe ekzekutive, përmes programeve të zhvillimit, mentorimit, rrjetëzimit dhe mundësive për të udhëhequr projekte transformuese”.

Gjatë eventit u theksua se, krahasuar me potencialin, ka

të vendimmarrjes në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Këto sfida lidhen me kufizimet që ka sjellë ekonomia e varfër, e mbyllur dhe lokale, si dhe mendësia e mungesës.

Ndaj, Women on Board Albania sheh me rëndësi rolin e saj në këtë kohë, pikërisht kur Shqipëria është e angazhuar të integrohet në Evropë.

Kjo do të kërkojë që bizneset shqiptare të rriten suksesshëm jashtë Shqipërisë dhe bizneset e huaja të tërhiqen dhe të rriten suksesshëm brenda Shqipërisë.

Modeli aktual i qeverisjes së biznesit shqiptar nuk i përgjigjet këtyre kërkesave.

5 shtyllat kryesore ku fokusohet Women on Board janë:

1. Advokim për çështjet gjinore
 2. Zhvillimi i kompetencës së drejtuesve
 3. Krijimi i një grupi të qëndrueshëm talentesh të gatshëm për të operuar edhe në nivel ndërkombëtar
 4. Krijimi dhe edukimi i një rrjeti mbështetës të bashkëmoshatarëve dhe mentorëve
 5. Përfshirja aktive në projekte dhe studime transformuese, në përputhje me fushat strategjike të rritjes në vend.
- Eventi u mbështet nga Vrioni Consulting, me objektiv nxitjen e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes gjinore dhe partnerit në EWOB për ndarjen e eksperiencës së krijuar në hapjen e rruges.
- Ndërsa ka nisur programi vjetor i WOB AL, përkushtimi është: nxitja e edukimit, njohurive dhe ndryshimi i mentalitetit. Ngjarja Launch 2024 ishte vetëm fillimi i rrugëtimit tonë kolektiv drejt një të ardhmeje më të larmishme dhe gjithëpërfshirëse

Rreth WOB AL

Misioni i WOB AL shtrihet përtej të tashmes; Organizata mbjell sot farat e lidershit të ardhshëm.

Në udhëtimin tonë drejt një të ardhmeje më të larmishme dhe gjithëpërfshirëse, shfrytëzimi i mjeteve dixhitale bëhet parësor. Duke përqafuar teknologjinë, WOB AL dhe komuniteti i saj do të thyejë barrierat gjeografike, duke siguruar që edukimi i përshatur të shtrihet përtej shtigjeve tradicionale, duke përgatitur gratë për role me ndikim në bordet drejtuese.



Sa e vështirë të rrisësh presh? Fermerët në Qerretin e vjetër të Lushnjes tregojnë lodhjen si kultivues: Do shumë krahë pune...

Qerreti i vjetër është një nga fshatrat e Lushnjes që kulturë kryesore ka kultivimin e preshit.

80 për qind e familjeve në këtë fshat ka si burim kryesor të të ardhurave bujqësinë. Në këtë periudhë në oborret e shtëpive të tyre i gjen duke përgatitur preshin për t'a çuar në pikat e shitjes.

Muharrem Laze me bashkëshorten dhe dy djemtë me nuset punojnë prej vitesh me këtë kulturë.

“Është një produkt që do shumë krah pune dhe për këtë jemi bërë bashkë.

Ky vit duket i mbarë ndryshe nga vitet E tjera pasi çmimi është i kënaqshëm ndryshe nga vitet e tjera ku nuk arrini të siguronin as koston”-



tha Muharrem Laze, banor i Qerretit.

E zonja e shtëpisë, Syme Laze tregon se që kur ka hyrë nuse që merret me bujqësi.

Augerti një nga djemtë

e familjes tregon se ka zgjedhur të punojë këtu dhe do vazhdojë të rrijë nëse produktet bujqësore kanë tregje dhe çmim të mirë

Në këtë fshat familje bëhen bashkë në këtë periudhë ku ka nevojë për shumë krah pune. Ne këtë mënyrë atë rrisin rendimentin dhe ulin koston që do shtohet nga marrja e punëtorëve.

Çmimi i këtij viti për një kg presh është 45 lekë. Ky është viti që çmimi i këtij produkti po i jep të ardhura të mjaftueshme fermerëve, duke kompensuar humbjet në kultura të tjera.

BUJQËSI

Shqiptarët u “dyndën” drejt vajit vendas të ullirit - Në 2023-shin importi preku fundin. Në janar ndryshoi situata

Vaji i ullirit “Made in Albania” po bëhet gjithnjë edhe më i preferuar për konsumatorët shqiptarë në raport me markat e huaja. Rritja e prodhimit të ullirit në vitin 2022 mbingopi tregun dhe çmimi i vajit të binte në mesatarisht 500 lekë për litër. Nisur nga kjo situatë, konsumatorët shqiptarë jo vetëm u nxitën të rrisnin konsumin e këtij produkti, duke zëvendësuar vajin e luledielliit, por edhe të orientoheshin drejt prodhimit vendas.

Të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Siguruara nga SCAN TV, tregojnë se importi i vajit të ullirit nga jashtë përgjatë vitit 2023 ka pësuar një rënie drastike krahasuar me krahasuar me vitin 2022.

Konkretisht në 2023-shin janë importuar vetëm 39.6 ton vaj ulliri nga jashtë, nga 263.8 ton të importuara në vitin paraardhës, duke regjistruar një rënie drastike prej 85 për qind. E thënë ndryshe, importi i këtij produkti ka rënë me 7 herë.

Kërkesa më e lartë për vajin e ullirit ka qenë kryesisht gjatë sezonit veror, nga strukturat e

shërbimeve dhe akomodimit për shkak të bumit turistik, por edhe nga emigrantët që kanë përfituar për të bërë blerjet e nevojshme. Ndërsa një pjesë e mirë e sasisë së prodhuar u eksportua drejt Italisë, pas një marrëveshje të nënshkruar nga Ministria e Bujqësisë me au-



SHQIPTARËT U “DYNDËN” DREJT VAJIT VENDAS TË ULLIRIT NË 2023-SHIN IMPORTI PREKU FUNDIN. NË JANAR NDRY:

toritetet italiane, e cila i hapi rrugë shitjes së këtij produkti jashtë kufijve.

Por gjatë 2023-shit, duket se pema e ullirit nuk është në nivelin e një viti më parë sa i takon prodhimit, megjithatë të dhënat nga fermerët, tregtojnë se ka sasi të mjaftueshme

për të përmbushur kërkesën vendase.

Të dhënat e doganave, tregojnë sa i takon muajit Janar 2024, janë importuar 3.8 ton vaj ulliri, vihet re një rënie me afro 90 për qind krahasuar me janarin e vitit 2022, ndërsa tendenca është në rritje të moderu-

ar krahasuar me janarin e 2023, ku ndikim duket të ketë çmimi. Aktualisht një litër vaj po tregtohet me një çmim mesatar prej 800 lekësh/ litër. Në vitin 2022 prodhimi arriti në 152.6 mijë ton, ndërsa për 2023-shin ende nuk janë gjeneruar të dhënat zyrtare.

Kultivuesi i patates në Rabdisht të Dibrës: Skemat mbështetëse, një ndihmë e madhe për fermerët

70-vjeçari Agim Ismaili nga fshati Rabdisht i Dibrës e ka të

përqendrimin e ka në kultivimin e patates.



lidhur jetën me bujqësinë, pasi kultivon bimë të ndryshme, por

Shqetësim për fermerin është çmimi i ulët në treg por

edhe kostoja e lartë e punimit të tokës, farave dhe proceseve të mekanizimit. Megjithatë fermeri ia ai ia arrin të prodhojë deri në 8 ton patate në vit.

Përveç kulturës së patates, ky fermer kultivon edhe qersh, por që në sezonin e vjeljes përballlet me të njëjtin produkt që hyn nga vendet fqinje.

Fermeri shpreson që në të ardhmen ai të përfshihet në skemat subvencionuese të qeverisë shqiptare për sektorin e agrikulturës pasi ato janë një ndihmë mjaft e madhe për fermerët në përballimin e kostove në shërbimet e nevojshme agroteknike.

Mungojnë pikat e grumbullimit, peshkatarët kërkojnë certifikimin e peshkut të Prespës

Peshkimi në liqenin e Prespës është një nga profesionet e vetme që arrin të mbajë me të ardhura disa dhjetëra familje që të mos braktisin Pustecin. Por edhe ky profesion sa vjen dhe po bëhet më i vështirë për tu ushtruar.

Kjo nga mungesa e dëshirës së peshkatarëve të zonës, por nga pamundësia e tyre për të shitur peshkun që

kapin. Në këtë bashki mungon një pikë grumbullimi ashtu sikurse mungon edhe certifikimi



i peshkut të Prespës, pasi në shumë raste tregtarë të ndryshëm abuzojnë në treg duke shitur peshk të tjerë si të liqenit të Prespës.

Problematika e peshkatarëve të Pustecit është e njohur edhe nga kryetari i bashkisë, i cili inkurajon që të bëhen bashkë për të kërkuar nëpërmjet projekteve realizimin e kërkesave të peshkatarëve.

Bashkohen fermerët e serrave, vendosin çmime dysHEME për prodhimet e reja

Një grup i madh fermerësh nga zonat e Beratit, Fierit u bashkuan këto ditë për të marrë çmime dysHEME në negociatë me grumbulluesit dhe eksportuesit.

Sezoni bujqësor ka nisur të japë prodhimet e para të

të prodhuesit. Përveç eksportuesve ka disa grumbullues ndërmjetës. Këto arrijnë të përçajin fermerët duke dhënë çmime të ulëta, pasi prodhimi nuk pret, duhet të vilet menjëherë. Fermerët nën presionin për të shitur sa më parë

vit, por çmimet me shumicë nuk janë si të vjetshmet, por shumë më të ulëta.

“Kemi marrë informacione se këtë vit çmimet e perimeve në tregjet Europës janë më të ulëta, por ne jemi totalisht me humbje nëse e shesim një kilogram kastravec më pak se 70 lekë” tha fermeri Ziu.

Fermerët shqiptarë ndryshe nga ata të Rajonit dhe Europës nuk përfitojnë mbështetje direkte nga qeveria, por vendi ynë ka avantazhin gjeografik që nis sezonin e prodhimit së paku 20 dita para vendeve të tjera të Rajonit, duke përfituar çmime më të larta eksporti në këtë periudhë. Mirëpo strukturat e brendshme të tregut vuajnë nga mbikëqyrja dhe spekulimi i lartë duke bërë që të gjitha anomalitë e zinxhirit bujqësor të bien mbi prodhuesin.

Bujqësia shqiptare në përgjithësi vuan nga kostot e larta të prodhimit, për shkak të fragmentimit të lartë të tokës dhe mungesës së mekanizimit, kostot e larta të imputeve etj.

Këto kosto nuk zbuten as nga subvencionet e qeverisë si në vendet e tjera. Kjo ecuri është duke i bërë prodhimet shqiptare jo konkurruese me importin, teksa eksportet kanë nisur tkurrjen e shpejtë. Në janar 2024 eksporti i perimeve shënoi rënie vjetore me 20%, ndërsa importet në këtë grup u rriten me 80%.



serrave. Tani po vilen kastravecë, por çmimi i grumbulluesve arriti më pak se gjysma e kostos me vetëm 20 lekë për kilogram javën e kaluar.

Të ekspozuar ndaj çmimeve të tregut, pa mbështetje financiare nga qeveria fermerët provuan të bashkohen javën që kaloi për të vendosur një çmim dysHEME për prodhimin e ri. Për dy ditë prodhuesit ranë dakord të mos vilnin duke bllokuar edhe eksportin. Në këtë mënyrë ato arritën të shisin në fillim të kësaj javë me mbi 60 lekë për kilogram, gati dyfishi në krahasim me javën e mëparshme.

“Ka një deformim të tregut dhe çmimit gjithmonë në dëm

se ndryshe thellohet humbja, pranojnë çmime të cilat nuk mbulojnë as kostot” Tha Mariglen Ziu një fermer më përvojë të gjatë të kultivimit në serra në zonën Samaticës në Berat.

Ziu tha se bashkimi më fermerët e tjerë për të negociuar çmimet e shitjes ishte një precedent që mund të vlejë për heret e tjera.

Vitin e kaluar perimet e serrave kastravec dhe domatja u eksportuan me çmime mjaft të larta mbi 100 lekë për kilogram, për shkak të mungesës së prodhimit në Spanjë dhe Itali. Nisur nga fitimet e vitit të kaluar fermerët zgjeruan sipërfaqet e serrave këtë

Fermerët detyrohen të ulin çmimet, rritet kërkesa për blerje, ja çfarë ndikoi

Ditët e fundit fermerët e qarkut të Korçës po shesin prodhimet e mollës, qepës dhe patates.

E gjithë kjo sipas tyre ka ardhur për dy arsye, së pari për shkak të uljes së çmimit që i kanë bërë produkteve e së dyti rritjes së referencave doganore nga ana e qeverisë shqiptare për prodhimet e importit si dhe rritjen e kontrolleve të produkteve bujqësore në dogana.

Ky është Petraq Andoni, grumbullues molle në fshatin

ka patur së fundmi treg të mollës.

“Ka lëvizur ditët e fundit lëvizja e mollëve sepse ka ndodhur që ne ulwm pak çmimin, u rrit dhe pak referenca nëpër dogana mbase, e po lëviz diçka. Që po shesim nga pak, jo të themi kënaqshëm por po heqim pak mollë. Mbase janë bërë këto që fliten, por shikojmë që ne po lëvizim diçka”, tha Petraq Andoni, grumbullues.

Te njëjtën gjë e pranon dhe Besnik Dervishaj, fermer

“Vazhdon të shitet por kemi ulur pak çmimin, 5 lek për kg dhe kjo dogana që u rrit referenca nëpër dogana na ka ndihmuar. Po vijmë po kërkoni në por jo shumë me, këtu në këtë mes fiton tregtari, se fiton 5 lek, na ka ndihmuar se po kërkoni. Gati është në përfundim në fshatin tonë, 3 – 4 shtëpi kanë qepë”, tha fermeri Besnik Dervishaj.

Arben Dulellari, drejtor i bujqësisë në bashkinë e Maliqit zyrtarisht ka bërë me dije se për të mbrojtur fermerët qeveria ka marrë masa doganore për prodhimet e huaja.

“Realisht kohët e fundit ka rritje të tregtimit të mollës e qepës. Ka ardhur rrjedhojë e masave që ka marrë qeveria për të rritur çmimet e referencës për produktet që hyjnë brenda vendit, kontrollet për analiza e kjo ka sjellë rritje të tregtisë së prodhimit vendas”, tha Arben Dulellari, drejtor i Bujqësisë në Bashkinë e Maliqit.

Vetëm në bashkinë e Maliqit këtë vit janë prodhuar 16 mijë ton mollë, 25 mijë ton qepë dhe 23 mijë ton patate.



FERMERËT “DETYROHEN” TË ULIN ÇMIMET SHTOHEN KËRKESAT, NDIKIM RITJES E ÇMIMIT TË REFERENCËS NË DOGAN

Zvirinë të bashkisë së Maliqit. Ai tregon se për këto dy arsye

potencial i cili merret me prodhimin e qepës.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

Kredi Agrobiznes 

A mund të blej makineri dhe
pajisje të reja bujqësore?

*SIGURISHT,
BËHET!*



 **CREDINS bank**

www.bankacredins.com

Tel.: +355 4 53 53 000

